

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga paratë e “Bankers” te ndërtimi – Qeveria “shpërblen” Behar Çukajn, i jep leje për 5 kulla të quajtura “Kashari Center”!
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/07/nga-parate-e-bankers-te-ndertimi-qeveria-shperblen-beh-ar-cukajn-i-jep-leje-per-5-kulla-te-quajtura-kashari-center-2/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:43:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 17:55:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8b6d431e9221a809e94a155f57be3eebc7e2fcd3c35ba5925d02b8ad85053a9f
TEKSTI	51a7411da9f69de207c037cfd8089631eaf9a900b3a68994598caf06f500d85
PAMJA	37bafce54b312bf2697543a83742d4f20032e11c21dc7c9b91d1e75ba5a39a79

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	52d486fc2e9c7ee0cf1d10c62e9eb86e1dcf2f6acc54483e0a6f176abe4665b6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/52d486fc2e9c7ee0cf1d10c62e9eb86e1dcf2f6acc54483e0a6f176abe4665b6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nga paratë e "Bankers" te ndërtimi - Qeveria "shpërblen" Behar Çukajn, i jep leje për 5 kulla të quajtura "Kashari Center"!

Kryesore

Publikuar: 07/09/2026

f X



Një nga fenomenet më të rënda në dosjen "Bankers", e hetuar fillimisht nga Prokuroria e Fierit dhe më pas nga Prokuroria e Posaçme, ka qenë implikimi i disa pronarëve të kompanive që kanë lidhur kontratë me koncesionarin, të cilat kanë thithur e përthithur dhjetëra miliona euro, duke u kthyer më fitimprurëse sesa vetë firma mëmë. Këto kompani janë quajtur me të drejta "shushunja" të cilat kanë bërë kontrata të majme, ndërkohë që në atë zonë operonin dhjetëra të tilla, shqiptare dhe të huaja.

Hetimet e prokurorisë kanë nxjerrë se drejtuesit shqiptare të "Bankers" kishin krijuar kompanitë e tyre, me pronarë shqiptare, bashkëpunon dhe ndoshta ndanin paratë, ndërkohë që e njëjta skemë përdorej edhe nga drejtuesit kinezë, të cilët arritën që të katapultonin në krye të disa firmave private njerëzit e tyre. Të dyja fenomenet kishin qëllim tjetërsimin e parave të nëntokës shqiptare, pasi në këtë mënyrë nuk paguanin detyrime ndaj pushtetit qendror, lokal apo ndaj banorëve të zonës.

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJESIE TE KUFIZUAR
"KASHARI CENTER" SH.P.K.

Me te lexuarat

Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Besnik Leskaj...

Besnik Leskaj i mori në punë të birin. Postet në merrshmi i administratës së Beratit / Si...

Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik Rokalli qadiga e Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit...

Enri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Enri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Themeluesi qe nenshkruan me poshte si vijon:

- 1) Behar ÇUKAJ, shtetas shqiptar, i datelindjes 12.06.1962, lindur ne Fier dhe banues ne Tiranë, identifikuar me nr. personal G [REDACTED], madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise "KASHARI CETER" SH.P.K.

Sot me date 10.04.2025, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare", vendosen te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, e cila e ushtron aktivitetin e saj pa afat, ne baze te kushteve qe vijojejne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Një nga emrat që ka dalë në këtë dosje është edhe 64 vjeçari Behar Çukaj, nga qyteti i Fierit, i cili është pronar i disa kompanive, me në krye Bolv Oil, teksa selia qendrore e kësaj firme është në zonën e Marinzës, atje ku operon edhe koncesionari "Bankers". Për vite me radhë, firmat e Çukajt kanë lidhur kontrata me firmën që shfrytëzon burimin më të madh të hidrokarbureve në Shqipëri, fushën naftëmbajtëse Patos – Marinzë, ndërkohë që pasi voli mirë e mirë, kompanitë e tij janë fokusuar tashmë te ndërtimi, kryesisht në Tiranë.

Faksimile: Leja e qeverisë për kompleksin "Kashari Center", në pronësi të biznesmenit Behar Çukaj

Sipas dokumenteve që disponon Prapaskena qeveria shqiptare ka zbardhur javët e fundit një nga lejet e radhës për ndërtimin në Shqipëri, i quajtur "Kashari Center", i cili do të ngrihet në hyrje të Tiranës, në zonën pas "Casa Italia", në afërsi të dy komplekseve të tiera që kanë marrë leje. Me një sipërfaqe prej rreth 26 mijë

metrash katrorë, Çukaj do të ngrejë plot 5 kulla, mbitokë 9 kate dhe nëntokë 2 kate.

Më shumë se një leje, vendimi i qeverisë duket një “shpërblim” ndaj këtij emri, pasi megjithëse i ka dalë emri disa herë në dosjet penale, nga Prokuroria e Fierit dhe më vonë nga SPAK-u, sërish arrin të marrë leje dhe të ndërtojë. Raportet e ndryshme financiare apo hetimore kanë dalë në konkluzionin se paratë e pista në këtë vendin tonë kanalizohen në ndërtime, ndërkohë që rasti në fjalë duhet të hetohet nga këto organe ligjzbatuese, të cilat duhet t’u thonë shqiptarëve nëse pasuria e tyre nëntokësore po shkon në ndërtime.

(Vendndodhja e kullave)

Në dokumente përcaktohet se “Kashari Center” është një objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 9 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, me vendndodhje në Bulevardin e Kasharit, Tiranë, me zhvillues shoqëritë “Kashari Center” shpk dhe z. Behar Çukaj. Kompania “Kashari Center” është themeluar në vitin 2025 me pronar po z. Behar Çukaj.

“Zona ku do jenë objektet e propozuara gjendet në periferi të qytetit të Tiranës, në zonën e Kasharit, në një hapësirë urbane, e përdorur kryesisht për objekte banimi dhe shërbimi. Prona ndodhet përgjatë rrugës ‘Pavarësia’ dhe Bulevardit të Kasharit, në Kashar, dhe ka afërsi me autostradën Tiranë-Durrës. Kjo mundëson përfitimin nga afërsia me një nga arteriet kryesore të qytetit, por njëkohësisht e mbron nga fluksi i lartë i trafikut dhe zhurma” thuhet në dokumente.

Sipas tyre, prona që do të zhvillohet është terren i paurbanizuar, i karakterizuar nga vegjetacini i ulët. Trualli që kërkohet të zhvillohet ka një sipërfaqe totale prej 26.500 m². “Në zonë kanë filluar ndërtime të reja dhe komplekse bashkëkohore, duke

shënuar një transformim gradual të fytyrës urbane” vijon dokumenti. Në maketin e propozuar dhe miratuar nga KKTU duken se objektet janë në forma të rregullta drejtkëndore të shpërndara në terren duke ruajtur distancat ndërmjet tyre. Hyrja për në shesh bëhet e mundur nga ana lindore, jugore dhe perëndimore e tij dhe aksesohet lehtësisht nga tre rrugët që e kufizojnë sheshin.

Prapaskena shfletoi edhe dokumente të tjera ku rezulton se firma ndërtuese “Kashari center” është themeluar nga Behar Çukaj, 64 vjeç, lindur në Fier e banues në Tiranë. “Sot më datë 10 prill 2025, bazuar në vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me ligjin, vendosën të themelojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e cila e ushtron aktivitetin e saj pa afat” thuhet në dokumente.

Pra, një kompani e themeluar vetëm 1 vit më parë ka arritur të marrë një super leje, të miratuar në 2025 dhe të zbardhur vetëm para disa javësh. Objekti i firmës është projektim dhe ndërtim i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë. Gjithashtu merret me veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt apo indirekt të lidhura me to.

Mund të lexoni;

Zbulohet linja e dytë e vjedhjes së Behar Çukajt me Bankers nërmes kompanisë Simmons. 35 milionë euro me

një dorë, i implikuar edhe i biri, refuzohet deklarimi në QKB i pronarëve

- TAG:
- Behar cukaj
- Kashari center
- Ndërtimi
- Paratë e bankers

Të ngjashme



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.